



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Oda e Avokatëve të Kosovës  
Palë ankuese  
Prishtinë

VENDIM

**Lidhur me Rastin 2023/85: Ankesa e Oda e Avokatëve të Kosovës (Palë ankuese) kundër  
KTV dhe ARTA**

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me datën 4 prill 2023 ka pranuar një ankesë nga Pala ankuese ndaj KTV-së dhe ARTA-s, lidhur me emisionet e “Betimi për Drejtësi” me titull “*Mashtrimet në emër të avokatëve*” të transmetuar me datën 11 mars 2023 dhe “*Lufta për llogaridhënie në OAK pas hulumtimit të “Betimi për Drejtësi”*”, të transmetuar me datën 19 mars 2023.
3. KPM, me qëllim të vlerësimit të pretendimeve ankimore me datën 6 prill 2023, i ka dërguar shkresë KTV-së dhe ARTA-s përmes të cilës ka kërkuar sqarim për ankesën e parashtruar.
4. KPM me datën 10 prill 2023 ka pranuar përgjigje nga KTV dhe ARTA, në të cilën theksohet se: “*Në sqarimin e z. Musliu që i ka ofruar KPM-së thuhet se, emisionet hulumtuese “Betimi për Drejtësi”, të transmetuara në lidhje me Odën e Avokatëve të Kosovës, janë realizuar duke respektuar standardet më të larta etike dhe profesionale, duke raportuar me saktësi, drejtësi dhe duke ju dhënë hapësirë të gjithë protagonistëve për ta dhënë versionin e tyre.*”
5. KPM ka analizuar Ankesën, Përgjigjen e KTV-së dhe ARTA-s dhe në bazë të Raportit të monitorimit të datës 5 maj 2023 ka gjetur se KTV dhe ARTA gjatë transmetimit të emisioneve “Betimi për Drejtësi” kanë trajtuar çështje të interesit publik, duke treguar se hulumtimi është bërë për të vërtetuar pretendimet dhe ankesat e qytetarëve lidhur me çështjet kontestuese, si dhe kanë ofruar mbulim të balancuar dhe pluralistik të çështjeve për çfarë është bërë hulumtimi, duke intervistuar të gjitha palët e përfshira në kontekst, si: protagonistët, zyrtarët dhe ekspertët.

6. KPM me datën 24 maj 2023 i ka dërguar Palës ankuese përgjigje në ankesë me të cilën përgjigje e ka njoftuar se KTV dhe ARTA kanë vepruar në pajtueshmëri me Kodin e Etikës KKPM-2016/03, pasi që nuk janë gjetur në shkelje lidhur me pretendimet ankimore.

#### Analiza ligjore

7. Komisioni i Pavarur i Mediave bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar se KTV dhe ARTA kanë vepruar në pajtueshmëri me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.
8. KPM pretendimet e Palës ankuese i ka trajtuar në kuptimin e nenit 6, paragrafi 2 dhe nenit 7, paragrafi 4, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
9. Neni 6, paragrafi 2, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

*“OSHMA-të duhet të sigurojnë një mbulim të balancuar të çështjeve me interes publik dhe çështjeve të kundërthënies politike dhe të sigurojnë një paraqitje pluralistike të pikëpamjeve, pa asnjë privilegj për ndonjë parti politike, këndvështrim politik apo ndonjë grup ose individ.”*

Pala Ankuese pretendon se ka pasur raportime të njëanshme, interpretime ligjore në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe në kundërshtim me konstatimet e gjyqtarëve të cilat trajtohen në këtë emision. KPM gjen se ky pretendim është i pa bazuar, se në emisionet e transmetuara ka paraqitur interesin publik, ku përmes hulumtimit qartazi ka transmetuar se hulumtimi është bërë për të vërtetuar pretendimet dhe ankesat e qytetarëve duke i verifikuar ato me raste konkrete. Po ashtu, këto emisione kanë ofruar mbulim të balancuar dhe pluralistik me materiale të ndryshme, si intervista të të gjitha palëve, si protagonistëve, zyrtarëve, ekspertëve, pastaj edhe të komunikatave dhe e-maila, lidhur me çështjet për çfarë është bërë hulumtimi.

10. Neni 7, paragrafi 4, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

*“Bisedat ose intervistat telefonike nuk duhet të transmetohen pa e njoftuar palën tjetër paraprakisht, përveç kur është fjala për interesin publik.”*

Pala Ankuese ankohet se janë paraqitur incizime brenda hapësirave të zyrave dhe ambienteve të Odës së Avokatëve të Kosovës, në mënyrë të pa autorizuar, duke mos njoftuar paraprakisht dhe duke forcuar edhe më tej bindjen se ky emision është në tërësi tendencioz, që ka për qëllim dëmtimin e kërreve aktual të Odës së Avokatëve të Kosovës. KPM gjen se transmetimi i incizimeve telefonike dhe në ambientet e zyrave të Odës së Avokatëve të Kosovës është bërë për shkak të interesit publik.


11. Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar se KTV dhe ARTA nuk kanë bërë shkelje të Kodit të Etikës KPM-2016/03 lidhur me emisionet e “Betimi për Drejtësi” me titull “*Mashtrimet në emër të avokatëve*” të transmetuar me datën 11 mars 2023 dhe “*Lufia për llogaridhënie në OAK pas hulumtimit të “Betimi për Drejtësi”*”, të transmetuar me datën 19 mars 2023.

## Vendim

12. Refuzohet si e pabazuar Ankesa e Palës ankuese, përmes së cilës pretendohet se KTV dhe ARTA kanë bërë shkelje të Kodit të Etikës KPM-2016/03 lidhur me emisionet e “Betimi për Drejtësi” me titull “*Mashtrimet në emër të avokatëve*” të transmetuar me datën 11 mars 2023 dhe “*Lufta për llogaridhënie në OAK pas hulumtimit të “Betimi për Drejtësi”*”, të transmetuar me datën 19 mars 2023.

## E drejta për ankesë

13. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
14. Bordi për Ankesa do t’i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Jeton Mehmeti  
Kryetar



24.11.2023  
Datë